

Medresetë në kohën e Osmanlinjëve dhe poosmane

(Temë e mbajtur në radio Vatin për tender në kuadër të Këshillit për radiofuzion të RM)

Medrese në kuptimin etimologjik don të thotë shkollë, ndërkaq në kuptimin terminologjik don të thotë vendi apo institucioni ku mësohen dituritë Islame. Përndryshe termi **medrese** në kuptim semantik të fjalës ka shumë kuptime. Mësimi në formë të organizuar, mund të themi edhe në formë institucionale, është zhvilluar gati prej ditëve të para të Shpalljes Kur'anore. Edhe pse në këtë kohë është zhvilluar krejt në mënyra tjera nga këto të sotmet, por është e rëndësishme se fillet e shkollimit datojnë që nga ditët e para të Islamit. Këtë dëshmon rasti i Betejës së Bedrit kur muslimanët robëruan një numër të konsiderueshëm nga pala e musghrikëve – kundërshtarëve. Ushtarët e robëruar mund ta shpague veten poqese ua mësonin dhjetë vetave nga muslimanët shkrim leximin.

Medresetë gjatyë historisë përjetojnë zhvillimin e vetë në kuptime të ndryshme. Në vendet Islame medreseja gjithmonë ka qenë vendi ku përgatiten kadro për profile ose drejtime të ndryshme. Them të ndryshme sepse me vet termin medrese tek muslimanët kuptohet shkollimi në të gjitha lëmitë qofshin ato fetare ose profane. Kjo ndarje bëhet shumë vonë, me sa duket, fillet i ka nga kolonialistët dhe imperializmi të cilët muslimanët deshën t'i paraqesin si armiq të shkencës, diturive profane dhe jetës së kësaj bote sepse muslimanët janë të krijuar nga Zoti vetëm për t'u munduar në këtë botë, njëherit të përpiqen që të fitojnë vetëm Ahiretin – jetën e amshueshme. Kuptimi i fjalës medrese u kufizua vetëm në mësimet fetare edhe nga politikanët e bllokut socialisto-komunist. Besimtari, sipas tyre duhet të mësoj vetëm aspektet fetare ndërkaq gjithëshka që ka të bëjë me këtë botë është në kundërshtim me besimtarin, andaj edhe tek ne sot e kësaj dite bëhet një ndarje e padrejtë e shkencës në atë fetare dhe profane – laike. Këtë nuk e them rastësisht sepse po qe se konsultojmë një fjalor të fjalëve dhe shprehjeve të huaja rreth termit medrese do të hasim në këtë kuptim të ngusht që është në kundërshtim me të vërtetën e fjalës. P. sh. Në librin Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja nga Mikel Ndreca, botim i Rilindjes në vitin 1986 hasim: **“Medrese – ja (ar. Madrasa – vend ku jepet mësim; tur. Medrese) shkollë e mesme ose e lartë fetare myslimane për të përgatitur hoxhollarë e myderizë.** Ngjashëm e gjejmë edhe te fjalori i fjalëve dhe shprehjeve të huaja të njohur tek ne, të Vujaklisë dhe të Kllajiqit. Të mos e zgjasë shumë rreth këtij shtjellimi, kujtoj se tani, në fillim të mileniumit të

tretë njeriu në mënyrë objektive do t'i qaset probleme shkencore pa i përkufizuar ato në kuptime negative sic ngjau gjer më tani. Shkollimi tek muslimanët qysh herët ka qenë i shkallëzuar ose i nivelizuar. Këtë vërtetojnë emrat e shkollave në kuptim tradicional si:

Mekteb – është quajtur shkolla fillore,

Medrese ose ruzhdije – është quajtur shkolla e mesme dhe

Xhami'a – është quajtur shkollimi universitar dhe pasuniversitar. Këto emërtime në kuptim të përgjithshëm kanë ngelur edhe sot e kësaj dite.

Me përhapjen e Islamit në botë, muslimanët pavarsisht se ku gjendeshin pranuan gati të njejtën formë të shkollimit e në këtë kuptim edhe muslimanët e Ballkanit gjatë prezencës së osmanlinjëve në trojet tona përdornin të njejtat emërtime të cikleve të shkollimit mbase me ca përjashtime.

Ndër aktivitetet tjera me të cilat u mor Perandoria Osmane në Ballkan dhe në vendet tjera të cilat i administronte ishte edhe hapja e medreseve. Forma më e njohur dhe më produktive e ngritjes së shkollave ka qenë hapja e shkollave private në bazë të cilës dhe morrën emërtimet vetë shkollat. Në Ballkan kanë vepruar shkollat e themeluara në emër të vakufëve të ndryshme por edhe të themeluesve tjerë. Kështu tek në janë të njohura medresetë e vjetra si: medreseja e Isa Beut në Shkup, medreseja e Gazi Husref Beut në Sarajevë, Medreseja e Alaiddinit në Prishtinë, medreseja e Sheh Shamisë në Shkodër etj.

Krahas këtyre medreseve në vendet tona kan punuar edhe medrese tjera të cilat kryesisht kanë mbajtur emrin e hoxhës i cili ka organizuar ose ka mbikqyrur shkollimin në formë klasike. Shkollimi apo mësimi i tillë zhvillohej më përcaktim konkrete të talebeve – nxënësëve. Lëminë të cilën dëshironte ta studiojë nxënësi, fillimisht duhej të kërkojë hoxhën – arsimtarin i cili do ta pranonte dhe më në fund pasi të kryejë ciklin e shkollimit merrte titullin kuakifikues. Shkollat e këtij lloji jan quajtur mektebe.

Me rënien e Perandorisë Osmane si duket në trevat tona kryesisht kanë vepruar mektebet e këtij lloji sepse nuk ka patur nevojë për ndonjë finansim serioz, andaj edhe kanë qenë më të suksesshmet. Njëherit me ndryshimet në sistemin politik dhe regjimin shtetëror mektebet e këtilla kanë patur mundësi që të veprojnë edhe në formë ilegale sepse sistemet shtetërore nuk i lejonin të punojnë.

Duke hulumtuar medresetë – shkollat e vjetra në trojet tona sot do flas më gjësisht për Medresenë e Isa Beut të vjetrën dhe të stomen.